



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	07.07.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-122062/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Norwegian PX Kosovë” SH.P.K
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-122062/21 nga “Norwegian PX Kosovë” SH.P.K me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike tek Matil në rrugën ”B” nga data 01 Korrik 2021 deri më 31 Korrik 2021 për vendosjen e një veture për lojë shpërblyese.  
Hapësira e nevojshme është 3m<sup>2</sup>.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin “Norwegian PX Kosovë” SH.P.K për shfrytëzimin e hapësirës publike prej 3m<sup>2</sup> për dhe vendosjen e veturës për lojë shpërblyese tek Matil në rrugën “B” nga data 10 Korrik 2021 deri më 12 Korrik 2021.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.